



UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan,
Republika e Kosovës www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

**RAPORT PËR VLERËSIM TË STAFIT AKADEMIK SI DHE LËNDËVE NGA
STUDENTËT E UNIVERSITETIT ‘KADRI ZEKA’, PËR SEMESTRIN DIMËROR
TË VITIT 2024/2025**

Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia e hulumtimit.....	3
2.1 Qëllimi i hulumtimit.....	3
2.2 Metodat e hulumtimit.....	3
3. Rezultatet e Hulumtimit	4
3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit.....	4
3.2. Analiza e pyetësorëve	4
3.2.1 Rezultatet e vlerësimit të mësimdhënësve të UKZ-së nga studentët sipas Njësive Akademike.....	4
4. Analiza e pyetësorëve	4
4.1 Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor	4
5. Përfundimet dhe rekomandimet	19

1. Hyrje

Matja e performancës e mësimdhënësit gjatë ligjëratave me studentë është një ndër matjet e rëndësishme për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet e studentëve ndërlidhen me planifikimin e punës nga ana e mësimdhënësit, organizimin e orëve mësimore, përdorimin e materialeve të duhura për lëndë, kreativitetin e tyre si dhe zbatimin e metodologjive bashkëkohore gjatë organizimit të orës mësimore.

Duke u bazuar në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ (Ref.nr.01/2913 dt. 18/12/2023) si dhe Manualin për Planifikim dhe Vlerësimi të Stafit Akademik (Ref.nr.01/2912 dt. 18.12.2023) është realizuar Vlerësimi i Stafit Akademik nga studentët për Semestrin Dimëror 2024/2025 në Universitetin “Kadri Zeka”.

Në kuadër të kësaj kemi plasuar pyetësonin në platformën SMU, kësaj radhe të kombinuar me pyetje edhe për lëndet edhe për performancën e mësimdhënësit.

2. Metodologjia e hulumtimit

2.1 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë realizimit të plan programeve mësimore të mësimdhënësve në UKZ, trajtimin e lëndëve përkatëse si dhe qasjen në përgjithësi të obligimeve që mësimdhënësi ka ndaj lëndës dhe studentit. Për atë arsye përpjekja jonë e vazhdueshme është që të kemi rezultate sa më reale.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat përcaktojnë shkallën e veprimit të mësimdhënësve brenda angazhimit të tyre profesional nëpër lëndë të caktuara të Programeve Studimore brenda Universitetit.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t’u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit i cili do të rekomandojë menaxhmentit të lartë të UKZ-së për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit për periudhën e Semestrit Dimëror 2024/2025, për përmirësimet eventuale.

2.2 Metodat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të dhënave.

□ Shpërndarja e pyetësorëve

Objekt hulumtimi ishin shtatë Programet Studimore të nivelit baçelor Pyetësorët u vendosën në SMU gjatë periudhës së paraqitjes së provimeve për semestrin dimëror 2024/2025, po ashtu plotësimi i tyre u bë gjatë këtij afati kohor.

3. Rezultatet e Hulumtimit

3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit

Duke u bazuar në instrumentet për vlerësim që përmban Manuali për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik (Ref.nr.01/2912 dt. 18.12.2023), studentët kanë vlerësuar sipas Shkallës së Likertit, ku studenti për secilin konstatim është dashur të rrumbullakoj 1, 2, 3, 4 ose 5 (5=*pajtohem plotësisht*; 4=*pajtohem*; 3=*nuk e di*; 2=*nuk pajtohem*; 1=*aspak nuk pajtohem*).

Duke u mbështetur në Kalendarin Vjetor për Sigurim të Cilësisë, ku është paraparë që pas çdo Semestri të bëhet vlerësimi nga ana e studentëve. Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në bashkëpunim me KMCV-në si dhe Koordinatorët e Cilësisë janë përcaktuar forma dhe përmbajtja e pyetësorëve për semestrin dimëror të Vitit Akademik 2024/2025. Ku është vendosur që të vlerësohen edhe mësimdhënësit edhe lëndët e tyre.

Të gjithë studentët që iu kanë nënshtruar provimeve në afatin e Janarit kanë plotësuar pyetësorët.

Regjistrimin e pyetësorëve në formë elektronike e bëri Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi. Duke u bazuar në Manualin për Planifikim dhe Vlerësimi të Stafit Akademik të gjithë mësimdhënësve të UKZ-së, rezultati i vlerësimit iu është dorëzuar në mënyrë individuale, në formë elektronike si dhe menaxhmenteve të fakulteteve u janë dorëzuar edhe raportet e përgjithshme për programe studimore dhe për fakultete në veçanti.

Për hartimin e Raportit me rezultatet e vlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi.

3.2. Analiza e pyetësorëve

3.2.1 Rezultatet e vlerësimit të mësimdhënësve të UKZ-së nga studentët sipas Njësive Akademike

4. Analiza e pyetësorëve

4.1 Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Qëndrimet e përgjithshme të Fakultetit të Edukimit nga studentët për semestrin dimëror 2024-2025 janë pasqyruar në tabelën numër 9 ku reflekton një nivel të lartë të kënaqësisë dhe cilësisë në procesin mësimor. Përgatitja e mësimdhënësve për lëndët që ata ligjërojnë është vlerësuar me një notë mesatare 4.72, duke treguar kompetencë të lartë akademike dhe përgatitje profesionale. Rregullsia dhe përkushtimi i tyre për të mbajtur ligjëratat në kohë është vlerësuar me 4.67, një tregues i disiplinës dhe seriozitetit në mësimdhënie. Studentët po ashtu kanë vlerësuar pozitivisht përfshirjen e tyre në klasë, ku inkurajimi i diskutimeve dhe aktiviteteve ka marrë notën 4.65, duke dëshmuar një angazhim të lartë për të krijuar një ambient interaktiv dhe bashkëpunues.

Përmbajtja e planprogrameve të lëndëve është konsideruar në përputhje me literaturën bashkëkohore (4.67), dhe materialet e lëndëve janë vlerësuar si të disponueshme dhe të dobishme për zhvillimin e njohurive dhe aftësive (4.64 dhe 4.66 respektivisht). Studentët

kanë vlerësuar drejtësinë dhe transparencën në vlerësim (4.66) si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre (4.68), duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të drejtë dhe objektive në procesin e vlerësimit. Po ashtu, qasja e hapur dhe disponueshmëria e mësimdhënësve për konsultime ka marrë një vlerësim të lartë prej 4.69, duke treguar përkushtimin e tyre në mbështetjen akademike të studentëve.

Në përgjithësi, nota mesatare e përgjithshme prej 4.67 pasqyron një mjedis akademik cilësor, ku mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit janë të angazhuar për të ofruar një përvojë mësimore të pasur dhe të efektshme për studentët e tyre.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.72
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.67
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.67
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.65
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.65
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.67
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.64
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.66
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.66
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.68
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.66
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.69
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.67

Tabela 9. Fakulteti i Edukimit (Baçelor)

Qëndrimet e studentëve për asistentët e Fakultetit të Edukimit janë paraqitur në tabelën 10. Përgatitja e asistentëve për ushtrimet e lëndës ka marrë një notë mesatare 4.75, duke dëshmuar një përkushtim të lartë në përgatitjen akademike dhe metodologjinë mësimore. Qartësia gjatë shpjegimeve në ushtrime është vlerësuar me 4.71, ndërsa transparenca dhe drejtësia në vlerësim kanë marrë nota të larta (4.72 dhe 4.67 respektivisht), duke treguar për një qasje të drejtë dhe të paanshme në vlerësimin e studentëve.

Po ashtu, asistentët janë vlerësuar për saktësinë në respektimin e orarit të ushtrimeve (4.73) dhe për kreativitetin në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera (4.69), duke ofruar një qasje më dinamike dhe tërheqëse për studentët. Inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive ka marrë një notë mesatare 4.70, ndërsa aftësia e asistentëve për të krijuar aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme është vlerësuar me 4.68, duke treguar një përpjekje të vazhdueshme për të lehtësuar procesin e të nxënit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është disponueshmëria e asistentëve për konsultime, e cila ka marrë një notë prej 4.74, duke dëshmuar mbështetjen dhe ndihmën e tyre të vazhdueshme për studentët. Respektimi i rregullave dhe sjellja profesionale janë gjithashtu vlerësuar lart, me një mesatare 4.72. Në përgjithësi, nota mesatare e përgjithshme prej 4.72 dëshmon se asistentët e Fakultetit të Edukimit janë një mbështetje e fuqishme akademike për studentët, duke ofruar cilësi të lartë në procesin mësimor dhe duke krijuar një ambient të favorshëm për të nxënit.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.75
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.71
3	Asistenti/ja është transparent	4.72
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.67
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.73
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.69
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.68
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.70
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.72

10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.70
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.72
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.74
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.72

Tabela 10. Fakulteti i Edukimit – Asistentet

Në tabelën 11, përkatësisht në pohimin 1, shihet se studentët e Fakultetit Juridik në mesatare paksa më të lartë vlerësojnë përgatitjen profesionale të mësimitdhënësve të tyre (4,44). Qëndrime të përafërta hasim në të gjitha pohimet e tjera ku mesatarja e pohimeve sillet prej 4.47 deri 4.53.

Një vlerësim pak më të zbehtë studentët e japin tek pohimi 2 dhe 7 ku shihet se studentët shprehen më pak të kënaqur me respektimin e orarit dhe vlerësimin. Mesatarja e përgjithshme në baçelor është 4.5.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimitdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.55
2	Mësimitdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.46
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.47
4	Mësimitdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.40
5	Mësimitdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.39
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.48
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.45
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.47
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.43

10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.42
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.48
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.50
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.46

Tabela 11. Fakulteti Juridik

Vlerësimi i mësimdhënësve të Fakultetit Juridik për semestrin dimëror 2024-2025 tregon një nivel të mirë të përgatitjes dhe angazhimit në procesin mësimor, me një notë mesatare të përgjithshme prej 4.46. Përgatitja akademike e profesorëve për lëndët është vlerësuar me 4.55, duke treguar një qasje serioze dhe të mirëstrukturuar në mësimdhënie. Rregullsia dhe përkushtimi për të ndjekur orarin e ligjëratave kanë marrë një vlerësim prej 4.46, duke reflektuar disiplinë dhe përkushtim profesional.

Qartësia e qëllimeve dhe objektivave të lëndës në syllabus është vlerësuar me 4.47, ndërsa përputhshmëria e përmbajtjes së planprogramit me literaturën bashkëkohore ka marrë 4.48, duke dëshmuar për përdorimin e materialeve të përditësuara dhe cilësore në procesin akademik. Disponueshmëria e materialeve të lëndës, si literaturat, ligjëratat dhe sllajdet, është vlerësuar me 4.45, duke siguruar aksesin e studentëve në burime të nevojshme për të nxënëit.

Sa i përket angazhimit të mësimdhënësve për të inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë, vlerësimi ka rezultuar në 4.40, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera është vlerësuar me 4.39, duke lënë hapësirë për përmirësime në metoda më inovative të mësimdhënies. Ambientin mësimor dhe inkurajimin e studentëve për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre e ka marrë një vlerësim prej 4.43, duke dëshmuar një klimë të përshtatshme për debatin akademik dhe përfshirjen aktive të studentëve.

Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve dhe drejtësia në këtë proces kanë marrë nota 4.42 dhe 4.48, duke treguar një qasje të përgjegjshme dhe objektive në procesin e vlerësimit. Një aspekt i rëndësishëm është disponueshmëria e profesorëve për konsultime, e cila ka marrë një vlerësim prej 4.50, duke dëshmuar për mbështetjen e tyre akademike ndaj studentëve.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një nivel të kënaqshëm të mësimdhënies në Fakultetin Juridik, me një qasje të strukturuar dhe të drejtë në raport me studentët, ndërsa ka hapësirë për përmirësime në kreativitetin dhe nxitjen e interaktivitetit në mësimdhënie.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.48
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.44
3	Asistenti/ja është transparent	4.42
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.38
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.42
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.41
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.42
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.41
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.46
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.43
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.47
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.46
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.44

Tabela 12. Fakulteti i Juridik – Asistentet

Vlerësimi i asistentëve të Fakultetit Juridik për semestrin dimëror 2024-2025 reflekton një performancë të kënaqshme, me një notë mesatare të përgjithshme prej 4.44. Përgatitja e asistentëve për ushtrimet e lëndëve është vlerësuar me 4.48, duke treguar një angazhim të mirë në shpjegimin e koncepteve dhe ushtrimeve praktike. Qartësia gjatë ligjërimit në ushtrime ka marrë një vlerësim prej 4.44, duke dëshmuar përpjekjet e asistentëve për të komunikuar në mënyrë efektive me studentët.

Sa i përket transparencës dhe drejtësisë në vlerësim, këto janë vlerësuar me 4.42 dhe 4.38, duke treguar një qasje përgjithësisht të drejtë dhe objektive në procesin e vlerësimit të studentëve, megjithëse mund të ketë hapësirë për përmirësime të mëtejshme në këtë aspekt. Saktësia në respektimin e orarit ka marrë një notë prej 4.42, duke treguar një disiplinë të mirë në mbajtjen e orëve të ushtrimeve.

Kreativiteti në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve shtesë, si dhe aftësia për të krijuar aktivitete që ndihmojnë në kuptimin e lëndës, janë vlerësuar me 4.41 dhe 4.42, duke treguar një përkushtim në zhvillimin e metodave të ndryshme pedagogjike për të ndihmuar studentët. Asistentët kanë inkurajuar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në nivelin 4.41, ndërsa aftësia për të krijuar një ambient ku studentët mund të bëjnë pyetje lirshëm ka marrë një vlerësim të lartë prej 4.46.

Një aspekt i rëndësishëm është kërkesa për interaktivitet gjatë ushtrimeve, e cila është vlerësuar me 4.43, si dhe sjellja e asistentëve në përputhje me rregulloren, e cila ka marrë notën 4.47, duke treguar profesionalizëm dhe etikë në marrëdhënien me studentët. Disponueshmëria e asistentëve për konsultime është vlerësuar me 4.46, duke dëshmuar për një qasje mbështetëse ndaj studentëve jashtë orëve të ushtrimeve.

Në përgjithësi, asistentët e Fakultetit Juridik kanë demonstruar një performancë të mirë në aspektin akademik dhe profesional, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për të nxënëit dhe duke ofruar ndihmë të vazhdueshme për studentët. Megjithatë, ka hapësirë për përmirësime në transparencën dhe drejtësinë në vlerësim, si dhe në krijimin e metodave më inovative dhe interaktive të mësimdhënies për të rritur angazhimin e studentëve.

Qëndrimet e përgjithshme të studentëve të Fakultetit Ekonomik për Staf Akademik janë paraqitur në tabelën 13.

Vlerësimi i mësimdhënësve për këtë semestër ka një mesatare të përgjithshme prej 4.62, duke reflektuar një nivel të lartë të përgatitjes dhe angazhimit të tyre. Përgatitja për lëndën (1) është vlerësuar me 4.74, ndërsa qartësia e objektivave në syllabus (3) me 4.64, duke dëshmuar një strukturim të qartë të materialeve. Rregullsia dhe saktësia në ligjërata (2) është 4.60, ndërsa vlerësimi i drejtë dhe i vazhdueshëm i studentëve (10, 11) ka marrë 4.62 dhe 4.63.

Përmbajtja e planprogramit dhe përputhja me literaturën bashkëkohore (6) është vlerësuar me 4.62, kurse disponueshmëria e materialeve (7) dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e njohurive (8) me 4.60 dhe 4.61, duke treguar qasje profesionale në ndihmën ndaj studentëve. Inkurajimi i aktiviteteve dhe diskutimeve në klasë (4) ka marrë 4.57, ndërsa kreativiteti në mësimdhënie (5) është 4.54, duke lënë hapësirë për përmirësime në metodat interaktive.

Disponueshmëria për konsultime (12) është vlerësuar me 4.65, duke treguar gatishmërinë e profesorëve për të ndihmuar studentët jashtë ligjëratave. Ambientet që inkurajojnë shprehjen e mendimeve (9) kanë marrë 4.56, duke reflektuar një atmosferë pozitive për debat akademik. Në përgjithësi, performanca e mësimdhënësve është e lartë, me mundësi për avancime në përfshirjen më aktive të studentëve në procesin mësimor.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.74
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.60

3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.64
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.57
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.54
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.62
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.60
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.61
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje te mendimeve/ideve	4.56
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.62
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.63
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.65
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.62

Tabela 13. Fakulteti Ekonomik

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.57
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.54
3	Asistenti/ja është transparent	4.52
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.52
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.63
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.46
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.46

8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.54
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.65
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.54
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.66
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.64
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.57

Tabela 14. Fakulteti Ekonomik - Asistentet

Në tabelën 14, janë shprehur qëndrimet për asistentët e Fakulteti Ekonomik.

Asistentat janë vlerësuar me një mesatare të përgjithshme prej 4.57, duke reflektuar përgatitje të mirë dhe qasje profesionale në ushtrimet praktike. Përgatitja për ushtrime (1) ka marrë 4.57, ndërsa qartësia në shpjegime (2) dhe transparencë (3) janë vlerësuar me 4.54 dhe 4.52, duke treguar qartësi dhe drejtësi në komunikim.

Saktësia në orë (5) ka rezultuar me 4.63, ndërsa drejtësia në vlerësim (4) me 4.52, duke reflektuar një proces vlerësimi të balancuar. Kreativiteti në zhvillimin e mësimit (6) dhe krijimi i aktiviteteve të dobishme (7) janë vlerësuar me 4.46, duke lënë hapësirë për rritje në përdorimin e metodave inovative.

Inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve (8) dhe interaktiviteti në ushtrime (10) kanë marrë 4.54, duke treguar një qasje bashkëpunuese. Studentët ndihen të lirë të bëjnë pyetje (9) me një vlerësim prej 4.65, ndërsa disponueshmëria për konsultime (12) është vlerësuar me 4.64, duke dëshmuar përkushtim ndaj studentëve. Sjellja e asistentëve në përputhje me rregulloren (11) ka marrë vlerësimin më të lartë prej 4.66, duke treguar etikë dhe profesionalizëm.

Në përgjithësi, asistentët kanë performuar mirë, me mundësi për përmirësim në kreativitet dhe inovacion në metodat e mësimit.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.45
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.28

3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.40
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.36
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.25
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.38
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.30
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.31
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje te mendimeve/ideve	4.31
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.25
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.34
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.28
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.33

Tabela 14. Fakulteti I Shkencave Kompjuterike

Mësimdhënësit e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike janë paraqitur ne tabelën 14 ku janë vlerësuar me një mesatare të përgjithshme prej 4.33, duke reflektuar një nivel të kënaqshëm të përgatitjes dhe angazhimit akademik. Përgatitja për lëndën (1) ka marrë vlerësimin 4.45, ndërsa qartësia e qëllimeve dhe objektivave në syllabus (3) është vlerësuar me 4.40, duke treguar një strukturë të qartë të lëndëve.

Rregullsia dhe përpikëria në ligjërata (2) ka një vlerësim prej 4.28, ndërsa inkurajimi i diskutimeve dhe aktiviteteve në klasë (4) ka marrë 4.36, duke treguar hapësirë për përmirësim në nxitjen e ndërveprimit me studentët. Kreativiteti në mësimdhënie (5) ka vlerësimin më të ulët, 4.25, duke sugjeruar nevojën për metoda më inovative dhe praktike.

Përputhja e planprogramit me literaturën bashkëkohore (6) është vlerësuar me 4.38, ndërsa disponueshmëria e materialeve mësimore (7) ka marrë 4.30, duke treguar përpjekje për të siguruar burime të aksesueshme për studentët. Ndikimi i materialeve në zhvillimin e njohurive (8) dhe ambienti i favorshëm për shprehjen e ideve (9) janë vlerësuar me 4.31, duke reflektuar një mjedis mësimor të qëndrueshëm, por me mundësi për përmirësim në përfshirjen e studentëve.

Vlerësimi i vazhdueshëm i punës së studentëve (10) ka marrë 4.25, duke treguar nevojën për qasje më të strukturuar në këtë aspekt. Drejtësia në vlerësim (11) është vlerësuar me 4.34, ndërsa disponueshmëria e mësimeve për konsultime (12) është vlerësuar me 4.28, duke treguar angazhim për mbështetjen e studentëve.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një performancë të mirë të mësimeve, me nevojën për të shtuar kreativitetin dhe përfshirjen e studentëve në mënyrë më aktive gjatë procesit mësimor.

Ndërsa në tabelën 15 janë paraqitur asistentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike ku janë vlerësuar me një mesatare të përgjithshme prej 4.46, duke reflektuar një nivel të mirë të përgatitjes dhe angazhimit në procesin mësimor. Përgatitja për ushtrimet (1) ka marrë vlerësimin 4.49, ndërsa qartësia gjatë ushtrimeve (2) është vlerësuar me 4.41, duke treguar një standard të kënaqshëm akademik.

Transparenca (3) dhe drejtësia në vlerësim (4) kanë marrë vlerësime të larta, përkatësisht 4.48 dhe 4.46, duke treguar një qasje të drejtë dhe të qartë në vlerësimin e studentëve. Përpikëria në orë (5) ka gjithashtu vlerësimin 4.46, duke reflektuar disiplinë dhe organizim të mirë.

Kreativiteti në zhvillimin e mësimit (6) dhe krijimi i aktiviteteve që e bëjnë lëndën më të kuptueshme (7) kanë marrë vlerësime 4.37 dhe 4.33, duke treguar një mundësi për të rritur angazhimin dhe inovacionin në metodat mësimore. Inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së studentëve (8) ka marrë 4.41, ndërsa studentët ndihen të lirë të bëjnë pyetje (9), me një vlerësim të lartë prej 4.56, duke reflektuar një qasje mbështetëse nga ana e asistentëve.

Kërkesa për interaktivitet gjatë ushtrimeve (10) ka marrë vlerësimin 4.43, ndërsa respektimi i rregullores (11) ka një vlerësim të lartë prej 4.54, duke treguar një nivel të mirë profesionalizmi. Disponueshmëria e asistentëve për konsultime (12) është vlerësuar me 4.46, duke treguar përkushtim në ndihmën ndaj studentëve.

Në përgjithësi, asistentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike shfaqin një nivel të mirë të performancës, me mundësi për përmirësim në aspektin e kreativitetit dhe inovacionit në metodologjinë e ushtrimeve.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.49
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.41
3	Asistenti/ja është transparent	4.48
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.46
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.46
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.37
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.33

8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.41
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.56
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.43
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.54
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.46
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.46

Tabela 15. Fakulteti I Shkencave Kompjuterike - Asistentet

Mësimdhënësit e Fakultetit të Shkencave Sociale, si një fakultet i ri i hapur me një programin e ri që është vlerësuar për herë të parë e që është paraqitur në tabelën 16, kanë marrë një mesatare të përgjithshme shumë të lartë prej 4.84, duke reflektuar një nivel të jashtëzakonshëm të përgatitjes dhe angazhimit akademik. Përgatitja për lëndën (1) është vlerësuar me 4.92, ndërsa përpikëria dhe rregullsia në ligjërata (2) ka marrë vlerësimin 4.81, duke treguar disiplinë dhe përkushtim ndaj procesit mësimor. Qartësia e objektivave të lëndës në syllabus (3) ka marrë vlerësimin e lartë 4.89, duke treguar një strukturë të qartë të planit mësimor.

Angazhimi për të nxitur diskutime dhe aktivitete në klasë (4) ka marrë 4.88, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera (5) është vlerësuar me 4.82, duke treguar përpjekje për një qasje inovative në mësimdhënie. Përputhshmëria e planprogramit me literaturën bashkëkohore (6) është vlerësuar me 4.84, duke siguruar që studentët të kenë njohuri të përditësuara.

Disponueshmëria e materialeve mësimore (7) dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e njohurive (8) kanë marrë përkatësisht vlerësimet 4.78 dhe 4.87, duke treguar se materialet janë të aksesueshme dhe ndihmuese për studentët. Ambienti në klasë që inkurajon shprehjen e ideve (9) është vlerësuar me 4.77, duke reflektuar një atmosferë të hapur dhe bashkëpunuese.

Vlerësimi i vazhdueshëm i punës së studentëve (10) ka marrë vlerësimin 4.79, ndërsa drejtësia në vlerësim (11) dhe disponueshmëria për konsultime (12) janë vlerësuar shumë lart me 4.84 dhe 4.85. Ky vlerësim i përgjithshëm konfirmon se programi i ri ka pasur një impakt jashtëzakonisht pozitiv, duke përmbushur pritshmëritë e studentëve dhe duke krijuar një standard të lartë akademik.

1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.92
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.81
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.89
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.88
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.82
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.84
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.78
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.87
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.77
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.79
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.84
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.85
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.84

Tabela 16. Fakulteti Shkenca Sociale

Asistentët e kësaj njësie akademike në tabelën me numër 17, janë vlerësuar jashtëzakonisht mirë nga studentët. Përgatitja për ushtrimet e lëndës (1) ka marrë një vlerësim të shkëlqyer me 4.91, duke reflektuar një nivel të lartë profesionalizmi. Qartësia gjatë ushtrimeve (2) është gjithashtu vlerësuar me 4.87, duke treguar aftësinë e asistentëve për të shpjeguar qartë dhe me saktësi konceptet. Transparenca (3) dhe drejtësia në vlerësim (4) kanë marrë gjithashtu vlerësime të larta me 4.92 dhe 4.89, duke treguar një angazhim për procesin mësimor të ndershëm dhe të hapur.

Asistentët janë gjithashtu të saktë në orë (5), me një vlerësim të shkëlqyer 4.91, dhe kreativë në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve (6), duke krijuar një mjedis mësimor interesant dhe të përfshirë. Aktivitete që bëjnë lëndën më të kuptueshme (7) janë vlerësuar me 4.91, duke

treguar se asistentët janë të aftë të thjeshtojnë materialet dhe t'i bëjnë ato të kuptueshme për studentët.

Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i studentëve janë inkurajuar fuqishëm nga asistentët, me një vlerësim 4.89 për inkurajimin e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes (8). Studentët kanë mundësi të bëjnë pyetje lirshëm (9), duke marrë një vlerësim të shkëlqyer 4.89, dhe interaktiviteti gjatë ushtrimeve (10) është gjithashtu mbështetur me një vlerësim të lartë 4.89.

Sjellja e asistentëve në përputhje me rregulloren (11) është vlerësuar shumë lart me 4.94, duke reflektuar një nivel të lartë profesionalizmi dhe respektimi të rregullave. Disponueshmëria për konsultime (12) është gjithashtu e shkëlqyer, me një vlerësim të lartë 4.87. Në përmbledhje, mesatarja e përgjithshme e asistentëve është 4.9, duke dëshmuar angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm dhe suksesin e programit të ri të lëndës.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.91
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.87
3	Asistenti/ja është transparent	4.92
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.89
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.91
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimi dhe aktiviteteve tjera	4.89
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.91
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.89
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.89
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.89
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.94
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.87
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.9

Tabela 17. Fakulteti Shkencave Sociale- Asistentet

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.60
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.48
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.53
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.48
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.44
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.52
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.48
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.49
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.47
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.46
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.51
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.50
13.	Komenti juaj lidhur me Profesorin dhe Lëndën	
	Mesatarja e përgjithshme	4.5

Tabela 18. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Stafit Akademik të UKZ-së nga ana e studentëve

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.54
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.48
3	Asistenti/ja është transparent	4.51
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.48
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.51
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.44
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.42
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.47
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.57
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.48
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.56
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.52
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.5

Tabela 19. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Asistenteve të UKZ-së nga ana e studentëve

5. Përfundimet dhe rekomandimet

Asistentët në Universitetin "Kadri Zeka" janë gjithashtu vlerësuar pozitivisht, me një mesatare të përgjithshme prej 4.5, e cila është e barasvlershme me atë të profesorëve. Disa nga aspektet kryesore të vlerësuara janë:

- Përgatitja për ushtrimet (4.54) dhe qartësia në shpjegime (4.48), që dëshmojnë një aftësi të lartë në transferimin e njohurive.

- Transparenca (4.51) dhe drejtësia në vlerësim (4.48), që nënkupton një qasje të barabartë dhe të paanshme ndaj të gjithë studentëve.
- Disponueshmëria për konsultime (4.52) dhe përshtatshmëria e sjelljes me rregulloren (4.56), që konfirmon një qasje të hapur dhe profesionale nga ana e asistentëve.
- Mundësia e studentëve për të bërë pyetje lirshëm (4.57), që sugjeron një mjedis të hapur për diskutim dhe bashkëpunim.

Megjithatë, fusha si kreativiteti në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve (4.44) dhe krijimi i aktiviteteve që ndihmojnë kuptueshmërinë e lëndës (4.42) janë aspektet ku mund të ketë përmirësime, duke sugjeruar nevojën për metoda më dinamike të mësimdhënies.

Në përgjithësi, vlerësimi pozitiv i studentëve tregon se mësimdhënësi/ja ka ofruar një përvojë mësimore cilësore dhe të përshtatshme për studentët, duke ndihmuar ata në arritjen e qëllimeve të tyre të mësimin dhe zhvillimit personal dhe akademik.

Rekomandimet e tona janë:

- Të hartohen syllabuset duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve dhe të monitorohet vazhdimisht arritja e këtyre rezultateve për të siguruar cilësi të lartë në procesin mësimor.
- Të inkurajohen mësimdhënësit për zhvillim të vazhdueshëm profesional përmes trajnimeve, seminareve dhe konferencave.
- Të organizohen trajnime brenda Universitetit për përfundimin e metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies, duke u fokusuar në zhvillimin e mendimit kritik tek studentët.
- Mësimdhënësit të respektojnë kriteret e vlerësimit dhe të vlerësojnë sistematikisht studentët gjatë semestrit për të siguruar një vlerësim objektiv dhe të drejtë.
- Të mbikëqyret përputhshmëria e literaturës në planprogram me literaturën që përdorin mësimdhënësit me studentët për të siguruar një përputhje të plotë akademike.
- Të krijohen dosje personale për performancën e secilit staf akademik në të gjitha njësitet akademike (NJA), duke përfshirë vlerësimet, trajnimin dhe zhvillimet e tyre profesionale.
- Dekanët të vazhdojnë të bëjnë koordinimin e plotë të planprogrameve mësimore me kurrikulat e reja për të siguruar një qasje të unifikuar dhe të përditësuar të mësimdhënies.
- Të gjenden forma të motivimit për mësimdhënësit që kanë treguar performancë të mirë gjatë vlerësimit, si shpërblime, mirënjohje dhe mundësi avancimi.
- Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës akademike dhe teknologjike për të mbështetur një mjedis më të mirë mësimor dhe kërkimor.
- Të zhvillohen kurse të reja dhe inovative që përputhen me nevojat e tregut të punës dhe interesat e studentëve, duke përfshirë teknologjitë e reja dhe trendet globale.
- Të promovohet dhe mbështetet kërkimi shkencor midis stafit dhe studentëve për të rritur cilësinë akademike dhe për të kontribuar në zhvillimin shkencor.
- Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar me universitete të tjera dhe institucione kërkimore për shkëmbim të përvojave dhe për të ofruar mundësi të reja për studentët dhe stafin.

Këto rekomandime synojnë përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e performancës së stafit akademik dhe studentëve.